



01.Nr.104/02-2163/2020
Kačanik, 21.01.2020

Në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT ORGANIZATIV KOMUNAL PËR KREMTIMIN E "17 SHKURTIT"- FESTA E SHALLJES SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

1. Me këtë vendim themelohet këshilli organizativ komunal për kremtimin e "17 Shkurtit"- festa e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, me anëtarët si në vijim:
 1. Ylber Bajra - koordinator i këshillit;
 2. Izahir Doda - anëtar;
 3. Ilirjana Berisha - anëtare;
 4. Ismajl Murseli - anëtar;
 5. Fatmir Çaka- anëtar;
 6. Remzije Dardhishta - anëtare;
 7. Hajrulla Shehu - anëtar;
 8. Ruzhdi Gjini - anëtar,
 9. Muharrem Ahmetaj - anëtar.
 10. Xhevdet Hysa - anëtar.
2. Përbërja e këtij këshilli është bërë në formën që të ketë gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve të cilët mund të kontribuojnë në kremtimin e përvjetorit.
3. Detyrat kryesore të këshillit janë që të organizojnë takime dhe të përzgjedhin formën më të mirë të shënimit të kësaj dite shumë të rëndësishme, përfshirë programin artistik, organizimin, orarin, ftesat, çështjet teknike etj.
4. Mandati i këshillit si në pikën 1. të këtij vendimi, përfundon me rastin e shënimit të kësaj dite, gjegjësisht më 17.02.2020.
5. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

I dërgohet:

Anëtarëve

Arkivit

